

KRONIKË

Vrasje me armë zjarri në Tiranë


Publikuar më: 16/12/2022, ora 17:38



Një vrasje me armë zjarri ka ndodhur pasditen e së premtes në Tiranë.

Sipas policisë, një person ka qëlluar me pistoletë një 49-vjeçar, i cili ndërroi jetë në spital. Viktima, sipas burimeve, është shtetasi Edmond Papa.

“Rreth orës 16.30, në rrugën “Fadil Bodinaku”, në lokalin në pronësi të shtetasit V. Sh., një person ende i pidentifikuar ka qëlluar me pistoletë shtetasin E. P., 49 vjeç, i cili si pasojë e plagëve të marra ka ndërruar jetë në spital”, bën me dije policia.



Vendngjarja e vrasjes

Në vendin e ngjarjes ndodhet grupi hetimor dhe po punon për sqarimin e rrethanave të ngjarjes dhe identifikimin e autorëve. Shërbimet e Policisë po vijojnë kontrollin e zonës për të bërë të mundur kapjen e autorit.

A2 CNN NEWSLETTER

Regjistrohuni për të marrë newsletter-in e A2 CNN. Çdo javë në adresën tuaj.

Email

REGJISTROHU

NA NDIQNI

